

VENDIM
Nr. 667, datë 12.9.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË AKTIVITETEVE NË
KUADËR TË MARRJES SË PRESIDENCËS SHQIPTARE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE TË
KËSHILLIT TË EUROPËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) eurosh, kundërvlehtë në lekë, për përballimin e shpenzimeve të aktiviteteve në kuadër të marrjes së presidencës shqiptare të Komunitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha